



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE

**ALBANIA**

**PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME**

22 prill, 2010

Për më shumë informacion:

Kontakti: Laureta Memo

Zyrë: +355-4-266-637

Cel: 0692033823

Email: [lmemo@lgpa.al](mailto:lmemo@lgpa.al)

<http://albania.usaid.gov>

[www.lgpa.al](http://www.lgpa.al)

## PRESS RELEASE

### **Nisma e Ditës së Tokës sjell përjasje të re për mbajtjen e Fierit të pastër dhe të bukur**

**FIER, 22 PRILL 2010** Nën moton “T’i japim një dorë qytetit të pastër” dhe me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, sot me dhjetëra qytetarë, organizata të shoqërisë civile, biznese dhe student morën pjesë në pastrimin e parë të të gjithë qytetit të Fierit.

Ngjarja e Ditës së Tokës u mundësua me mbështetjen e Bashkisë së Fierit, sektorit privat si dhe të disa donatorëve ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe USAID-in, Ambasadën e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri si dhe Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE). USAID kontribuoi me një shumë prej mbi 17,000 dollarë për blerjen e kazanëve të mëdhenj e të vegjël të mbeturinave, çantave prej rrobe dhe për ndërmarrjen e një fushate ndërgjegjësuese. Dy biznese, Banka Popullore dhe Euromarket, kontribuan për blerjen e pemëve dhe çantave prej rrobe përkatësisht.

Nisma për pastrimin ishte një ndër disa prej veprimtarive të kryera kohët e fundit në Fier për të mbështetur ndërgjegjësimin dhe politikat mjedisore. Me mbështetjen e USAID-it dhe OSBE-së, Bashkia organizoi disa seminare për çështjet mjedisore me rininë dhe median për të rritur angazhimin e tyre në këto çështje. Në shkollat 9-vjeçare, nxënësit mësuuan si dekompozohen materialet dhe mësimet të tjera në lidhje me ndërgjegjësimin mjedisor.

Sot nis edhe plani afatgjatë i Bashkisë për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta dhe zbulimin e qytetit ashtu siç parashikohet në projekt Strategjinë e Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, që mbështetet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shqipëri. Strategjia do të përmirësojë grumbullimin dhe administrimin e mbetjeve të ngurta, do të zgjerojë zonat e shërbimit në shumë zona të qytetit, do të ofrojë një plan të gjithanshëm financiar dhe operativ për investime si dhe do të prezantojë sistemin e riciklimit në mbarë qytetin. Si Ambasada e Mbretërisë së Holandës ashtu edhe Bashkia do të financojnë secila 110,000 Euro për zbatimin e strategjisë.

Sipas Drejtorit të Misionit të USAID-it në Shqipëri, Joseph Williams, strategjia ka një rrugë të gjatë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe për tërheqjen e investimeve në Fier. Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri do të vazhdojë të punojë me bashkinë e Fierit për të nxitur rritjen e ekonomisë vendore, për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe për forcimin e angazhimit të qytetarëve dhe sektorit privat në projektet vendore të zhvillimit të komunitetit.

###